



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË



Drejtoria e Inspektoratit

Raporti vjetor i punës për vitin 2011

Drejtoria e Inspektoratit, në kuadër të përgjegjësisë për monitorimin e implementimit të ligjshmërisë, udhëzimeve administrative dhe të rregulloreve të nxjerra nga Kuvendi Komunal, ka kryer gjatë vitit që shkoi një numër të madh të inspektimeve, të cilat kanë ndikuar në ngritjen e vetëdijes së përfaqësuesve të bizneseve, institucioneve publike dhe qytetarëve në respektimin dhe implementimin e këtyre akteve ligjore.

Numri i punëtorëve në këtë drejtori është 10, prej tyre .Drejtori, shefi i Inspektorëve ,Zyrtari Ligjor dhe 7 shtatë inspektorë .

Inspektimet janë kryer kryesisht në grupe 3-4 inspektor, e në raste të veçanta është punuar edhe në tërësi në grup, gjithmonë duke i lënë hapësirë edhe vet udhëheqësit të grupit të koordinoj për veprimet e marra.

Kontrollet inspektuese janë kryer edhe gjatë ditëve të vikendeve dhe festave, por sipas nevojës janë kryer edhe disa inspektime në bashkëpunim me Inspektorët e nivelit qendror dhe regjional.

Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës-njësia në Malishevë dhe ndërmarrjet publike si, Kompania për pastrim dhe ajo për furnizim me ujë të pijes ka qenë në nivelin ma të mirë të mundshëm, ndërsa me Gjykatën Komunale për Kundërvajtje nuk jemi të kënaqur me shqyrtimin dhe ekzekutimin e lëndëve të proceduara në këtë gjykatë.

Kjo drejtori gjatë këtij vitit ka pranuar gjithsejtë 83 kërkesa nga qytetarët e komunës sonë, kërkesat e pranuar i kemi shqyrtuar të gjitha në afat të caktuar kohor, gjithmonë duke u bazuar në ligjet dhe rregulloret e aplikueshme.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer mbi 1000 inspektime (kontrollime) të rregullta në institucionet publike komunale, private, shëndetësore, subjekteve afariste, qytetarëve pas parashtrimit të kërkesave, ku në këto inspektime janë përpiluar procesverbale si dhe janë dhen edhe vërejtje, sugjerime dhe këshillime gojore nga inspektorët.

Gjatë vitit 2011, nga kjo drejtori janë lëshuar 846 proces verbale, 97 aktvendime, 205 urdhëresa dhe vërejtje, 29 kërkesa gjykatës për fillim të procedurës për kundërvajtje, 17 kërkesa policisë, 78 pëlqime për leje për punë, 83 shqyrtime të kërkesave, është konfiskuar dhe njëkohësisht edhe është asgjësuar mall me afat të skaduar në vlerë prej 1541 €, kanë shqiptuar gjyba mandatore në vlerë prej 400 €, i kanë shpërndarë 582 aktvendime të taksës komunale për biznese.

Në muajt janar-shkurt, përveç detyrave të përditshme të Inspektorëve, kemi pasur edhe dy aksione me kërkesë të nivelit qendrorë dhe një aksion të rregull që ka drejtorja(pika 3),

- 1. Sensibilizimi dhe dhënia e vërejtjeve subjekteve afariste dhe institucioneve publike për ndalimin e pirjes së duhanit në hapësirat publike.*
- 2. Kontrollimi i subjekteve afariste që merren me përpunimin e drithërave të bardha (millit), me qëllim të verifikimit të sasisë së peshës të deklaruar në etiket.*
- 3. Kontrollimi i marketeve dhe vetësherbimeve në kontrollimin e artikujve ushqimor me afate te skaduar , dhe i njëjti aksion është përsëritur edhe në muajt qershor-korrik, me të vetmin qëllim për ta mbrojtur shëndetin e konsumatorëve.*

Gjatë muajit qershor përveç detyrave të përditshme të Inspektorëve, kemi ndërmarr edhe aksionin për mbyllje të disa lokaleve për shkak të mos pajisjes me Leje Pune Komunale, si dhe vazhdimin e aksionit për shpërndarjen e Urdhërësave subjekteve afariste për tu pajisur me Leje pune komunale.

Në vitin 2011 janë grumbulluar nga tatimi i Taksave Komunale 81529.50 € ,ku krahasuar me një vit më parë kemi ngritje të vlerës së inkasuar.

Nisur nga fakti se edhe për kundër problemeve dhe rrethanave tjera që na kanë përcjell gjatë kësaj periudhe raportuese prapë se prapë rezultatet janë evidente, dhe lirishtë mundë ta quajmë si vit i suksesshëm .

Është për tu vlerësuar puna e këtij sektori sepse gjatë vitit që lamë pas, nuk kemi asnjë vërejtje me shkrim nga ana e qytetarëve, lidhur me kryerjen e shërbimeve pranë kësaj Drejtorie.

Inspektorët Sanitar

Gjatë periudhës kohore janar- dhjetor 2011, nga Inspektorët Sanitar janë kryer mbi 400 kontrollime të ndryshme, janë shkruar 308 proces verbale, 1 kërkesë gjykatës, 3 pëlqime Sanitare. Inspektoret sanitar kanë kryer kontrolle inspektuese në objektet publike (Shkolla, Qendrat e mjekësisë familjare, Stacionin e Policisë - njësia Malishevë), si dhe objektet private si: shëndetësore, tregtare, hoteliere si dhe bizneset e tjera të cilat veprojnë në territorin e komunës sonë , me të vetmin qëllim që të kemi kushte më të mira higjieniko sanitare për të mbrojtur shëndetin e qytetarëve tanë

Kanë shpërnda nëpër lokalet publike dhe private edhe rregulloren dhe ligjin kundër duhanit dhe kanë urdhëruar bizneset që të ndajnë objektet e tyre afariste me përqindje të lejuar për ata që e përdorin duhanin .

Ne bashkëpunim edhe me inspektoret tjerë kanë kryere edhe detyra të tjera, siç është puna në komisionin për pranimin e objekteve për regjistrimin e bizneseve.

Inspektori i Tregut dhe Financiar

Kanë bërë inspektime të rregullta në të gjitha bizneset që veprojnë në komunën tonë, ku kanë kryer mbi 500 kontrollime të ndryshme, janë shkruar 169 proces verbale, janë lëshuar 198 urdhëresa dhe vërejtje, 1 kërkesë gjykatës, 78 pëlqime për leje për punë, ku njëri nga këta dy inspektor gjithëherë ka qenë pjesë e komisionit për pranimin e lokaleve afariste për të zhvilluar biznesin e tyre, kanë kryer edhe shumë punë të tjera në bashkëpunim edhe me sektorët tjerë .

Inspektori i Tregut dhe Financiar kanë bërë inspektime të subjekteve afariste së bashku në regjistrimin e subjekteve afariste në MTI-Prishtinë si dhe për pajisje me Leje Pune Komunale, ku gjatë këtij viti falë angazhimit të tyre, janë regjistruar si subjekte të reja 147 subjekte, prej tyre 78 subjekte janë pajisur me pëlqime për leje pune komunale, kurse pas krijimit të zyrës së Regjistrimit Komunal të Biznesit në Malishevë janë regjistruar 69 subjekte afariste të reja.

Njëkohësisht kanë bërë edhe grumbullimin e taksës komunale nga subjektet afariste të komunës së Malishevës.

Inspektori i ndërtimit

Si prioritet i këtij inspektori ka qenë mundësia e zvogëlimit të ndërtimeve pa leje ndërtimore dhe pajisja e qytetarëve me leje ndërtimi dhe futja në sistem të pagesave në çështjen e ndërtimeve. Për të gjitha ndërtimet legale dhe ilegale mund t'ju sigurojmë se janë të evidentuara dhe sipas ligjeve të aplikueshme edhe ka vepruar.

Gjate këtij viti ka inspektuar mbi 100 objekte ndërtimi, janë shkruar 83 proces verbale, 3 urdhëresa dhe vërejtje, 7 kërkesa gjykatës, si dhe ka qenë pjesë e komisionit për pranimin e lokaleve afariste për të zhvilluar biznesin e tyre, ka kryer edhe shumë punë të tjera në bashkëpunim edhe me sektorët tjerë .

Inspektori i Ambientit

Inspektori i Ambientit ka qenë i angazhuar kryesisht në mirëmbajtjen e pastërtisë të ambientit të jashtëm, në mirëmbajtjen e pastërtisë së qytetit, largimin e plehrave organike të vendosura afër vendbanimeve dhe të vendosura në pronat publike nëpër të gjitha fshatrat e komunës sonë, po ashtu ka realizuar shumë kontrolle sipas nevojës së paraqitura në teren si dhe pas parashtrimit të shumë kërkesave të palëve të natyrave të ndryshme si: kontrolle për ujëra të zeza nëpër prona private dhe publike, për hedhje të mbeturinave etj.

Gjate këtij viti ka inspektuar mbi 250 raste të ndryshme, janë shkruar 228 proces verbale, 15 aktvendime, 3 urdhëresa dhe vërejtje, 9 kërkesa gjykatës.

Është përkujdesur që Ndërmarrja komunale për higjiene të respektoj rregullat e përgjithshme për pastërtinë në qytet.

Inspektori i Komunikacionit

Inspektori i Komunikacionit ka zbatuar kryesisht Ligjin për Transportin Rrugor, Rregulloren për kryerjen e transportit të udhëtarëve me autotaksi dhe kombitaksi, konkretisht ka kryer inspektime sa i përket mirëmbajtjes së vijave urbane nga kompanitë transportuese, si dhe nga kombitaksit të cilët janë licencuar nga KK Malishevë, si dhe në bashkëpunim me Policinë kanë kryer kontrole të vazhdueshme për respektimin e kushteve nga ana e transportuesve të udhëtarëve dhe largimin nga komunikacioni të kombitaksive të cilët nuk kanë qenë të pajisur me leje pune komunale.

Ka inspektuar: autobusë, autotaksit, kombitaksit dhe autotransportuesit e zhavorrit, për të verifikuar se a janë të pajisur me licencat e punës, si dhe a i plotësojnë kushtet për punë.

Gjatë këtij viti ka inspektuar mbi 100 raste të ndryshme, janë shkruar 58 proces verbale, 17 aktvendime, si dhe u ka shqiptuar gjobë mandatore personave përgjegjës të kombitaksive në vlerë prej 400 €, për zhvillim të veprimtarisë pa leje pune komunale.

Vërejtje; Me këtë raport është bashkangjitur edhe Raporti vjetor në mënyrë Tabelare.

Vendi i punës, Inspektori	Proces Verbale	Aktvendime Vendime	Urdhëresa Vërejtje	Kërkesa Gjykatës	Kërkesa Policisë	Pëlqime Leje Pune	Shqyrtimi kërkesave	Shuma mall.asgj.€	Gjoba Mandatore	Inkasim i tax.komun.	Shpern aktv.tax.
Inspektori i Tregut Arsim Morina	88		93	1							
Inspektori i Ndërtimit Çlirim Karaqica	83		3	7							
Inspektori Sanitar Smajl Zogaj	165										
Inspektori Financiar Sahit Kafexholli	81		105								582
Inspektore Sanitare Syzana Morina	143			1							
Inspektori i Ambientit Xhavit Begaj	228	15	3	9							
Inspekt.Komunikac. Remzi Gashi	58	17							400		
Nga Shërbimi i Inspektoratit	xxxxx	65	1	11	17	78	83				
Gjithsejtë	846	97	205	29	17	78	83	1541	400 €	81,529.50 €	582